



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1331/prot.

Tiranë më 13.9.2019

Lënda: Mendim mbi projektvendimin

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 4169/8 Prot., datë 03.09.2019, me anë të së cilës kërkohet mendim mbi projektvendimin “Për miratimin të marrëveshjes për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit për qëllime të lidhura me migrimin, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Australisë”, Zyra e Komisionerit vlerëson të nevojshme të realizohen disa ndërhyrje konform parashikimeve të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Në këtë kuadër sugjerojmë që, pas germës (c) të nenit 3, të shtohet germa (d) me këtë përmbajtje: “(d) “Transmetim”, është transferimi i të dhënave personale të marrësit.

Gjithashtu, pas pikës 3, të nenit 6, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Palët marrin përsipër që transferimi apo përpunimi i të dhënave personale sipas kësaj marrëveshje do të bëhet në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe legjislacionin ndërkombëtarë në këtë fushë”.

Ndërkohë, në pikën 4 të nenit 6 të projekt marrëveshjes, parashikohet një ndër parimet kryesore të mbrojtjes së të dhënave, siç është përdorimi i të dhënave personale sipas qëllimit specifik dhe legjitim.

Sa më lart, vlerësojmë të rëndësishme përfshirjen edhe të parimeve të tjera ligjore duke sugjeruar të shtohen pikat si më poshtë:

5. “Pala që ka transmetuar të dhënat, duhet të sigurojë, që këto të dhëna të jenë të sakta dhe që përmbajtja e tyre t’i shërbejë qëllimit të kërkuar. Nëse konstatohet, që janë transmetuar të dhëna të pasakta ose të dhëna që nuk duhet të ishin transmetuar, atëherë pa humbur kohë duhet njoftuar pala marrëse. Pala e cila ka marrë këto të dhëna është e detyruar të korrigjojë apo të shkatërrojë ato.”;

6. *“Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen aq gjatë, sa e kërkon qëllimi për të cilin janë transmetuar.”;*
7. *Palët të cilat shkëmbejnë këto të dhëna janë të detyruara, që të dhënat personale të cilat janë transmetuar, të mbrohen nga aksesit i paautorizuar, ndryshimet dhe publikimi i paautorizuar.*

Gjithashtu, konstatojmë që bashkëlidhur projekt marrëveshjes mungojnë anekset e parashikuar në nenin 7 të saj, duke e bërë të pamundur dhënien e një mendimi mbi to.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

